



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 60 prot.

Kamëz, më 19 . 05 . 2021

V E N D I M

Nr 50 Datë 19/05/2021

P Ë R

**MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË LISTËN E PËRFITUESVE TË VENDIMIT NR. 169 DATË 23.12.2020, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT “PËR SHËMBJE”.**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.05.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt –Vendim Nr.45 Datë 11.05.2021 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, Urdherit nr.616 datë 11.12.2020 “Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në Lagjen Bathore, sipas listës bashkangjitur”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin Nr.169 Datë 23.12.2020 të subjekteve përfitues, për të cilët në këtë fazë konstatohet mosplotësimi i kriterëve ligjore për të përfituar nga

Adresa: Bulevardi Blu, Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: [keshilli.bashkiak@kamza.gov.al](mailto:keshilli.bashkiak@kamza.gov.al), web: [www.kamza.gov.al](http://www.kamza.gov.al)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KAMËZ**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

grantet e rindërtimit e shtëpive individuale sipas përbërjes familjare mbështetur ne V.K.M Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar pika V, tabela A.

Përbërja familjare	Sipërfaqja në metër katrorë (m2)	Masa e grantit
Deri në 2 anëtarë	60 m2 deri në 70 m2	Preventivi i projektit model
3 deri në 4 anëtarë	70 m2 deri në 80 m2	Preventivi i projektit model
5 e më shumë anëtarë	Jo më pak se 90 m2	Preventivi i projektit model

2. Lista e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli  
**Ali Dauti**

